

## KANUNI I VOGEL I SHEN MARISE

*Sherbesa nis me Lutjen Nistore:*

DHJAKU: Bekó, o Ate.

PRIFTI: I bekuar eshte Perendia yne, gjithenjë, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit e Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve, Amín.

Triní e Tereshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji

mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte, veshtroji, dhe sheroji semundjet tona per emrin tent. Meshiro, o Zot (*3 here*).

Ati yne, qe je ne qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbreteria jote; u-befte deshira jote si ne qell edhe mi dhé; buken tone te perdíçime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtóreve tane; edhe mos na shtier ne ngas-je, po shpetona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja eshte Mbreteria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pas Lutjes Nistore thuhet Psalmi 143:*

### PSALMI 143

O Zot, degjoma faljen, ver-u veshin lútjeve te mia. Pergjeqmu pas miresise dhe pas drejtesise sate, dhe mos hyr ne gjyq me sherbetorin tent, se asnjé njerí i gjalle nuke munt te dale i drejte perpara teje. Se armiku ma ndoqi shpirtin; ma shtypi jeten perdhé; me varrosi ne erresire si te vdekur prej kohe. Perandáj me eshte keputur shpirti, dhe me eshte deshperuar zemra. Kujtónj ditet e lashta, mejtónj gjithë veprat e tua. I ndeh dúarte perpara teje, shpirti im ka etje per ty posi dheu i thate. Pergjeqmu shpejt, o Zot, se m' u-zu fryma, mos e kthe menjane faqen tende prej meje, se jam bere si atá, qe hidhen ne gropë. Bej-me te shoh meshiren tende ne mengjés, se me ty kam shprese, bej-me te njoh udhen, ku du-

het te ecenj, se me ty e kam varrur shpirtin. Çlirome prej armiqve te mi, o Zot, se prane teje vinj te fshihem; mesome te benj deshiren tende, se ti je Perendia im; tregoma udhen e drejtesise, se ti je zemermire. Ngjall-me, o Zot, per emrin tent; edhe pas drejtesise sate nxirma shpirtin nga trubullimet; edhe pas meshres sate shtyp-i armiqte e mi; edhe shúaji te gjithë atá, qe ma mundojne shpirtin, se une jam sherbetori yt.

*Dhe menjehere thuhet Troparet pasónjese ne T. IV:*

Perendí dhe Zot, permi dhene na u-çfaq, i bekuar esht ay qe vjen ne émrin e Zotit (*4 here*).

Ejani le te rendim prane Hyjlíndeses, dhe te perunjur le t' i biem megjúnjazi, dhe me pendím te thelle le t'i thomi me shpirt: Zonje meshirónjese, nermjetó dhe shpetona, eja se u-mbytme krejt, nga mekakat e shuma; mos na largó né besniket e tu, se s' kemi tjtater shpresë dhe ndih-mese.

LAVDI DHE TANI. Do t'i leçitim kudó o Vir-gjereshe, çudit' e tua né te pavýerit, se po te mos na kishë dale mprójtese, si do te shpetonim valle prej kaqe rezikesh, dhe kush do na rúante gjer me taní te lire? Prej teje pra s' largóhemi aspák, se besniket po i shpetón gjithënjé nga çdo vrer.

*Pastáj thuhet Psalmi 51:*

### PSALMI 51

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe me shumicen e meshírave te tua shúaji paudhesít' e mia.

Laj-me fare prej paudhesisë sime, edhe qerome prej mekatit tim.

Se une i njoh paudhesit' e mia, edhe mekatin tim e kam perpara syve kurdoherë.

Kunder teje vetem fejeva, dhe perpara teje e bera te keqen, qe te dalesh i drejte ne fjalet e tua, dhe te jesh i kthjellet ne gjyqet e tu.

Se ja tek u-zura ne paudhesi, dhe ne mekata me lindi nena ime.

Se ja tek deshe te verteten ne zemër, edhe mendjes sime do t' i tregosh urtesí.

Sperkat-me me hysóp, edhe do te qerohem, lajme, dhe do te behem mé i bardhe se debora.

Bej-me te degjónj gezím dhe ngazellím, qe te me gezohen eshtrat e thýera.

Ktheje faqen nga mekatat e mia, edhe shúaji gjithe paudhesit' e mia.

Kthjelloma zemren, o Perendí, edhe perseritma frymen e drejte.

Mos me hith tej prej faqes sate, edhe mos ma merr frymen tende te shenjte.

Epma prape gezimin e shpetimit tent, edhe forcome me fryme zoterishte.

Do tu mesónj fajtóreve udhet e tua, edhe te pabeset do te kthehen me ty.

Shpetome prej gjakrash, o Perendí, Perendia i shpetimit tim, gjuha ime do ta lavderonje me gezím drejtesine tende.

O Zot, çelmi buzet, edhe goja ime do ta leçite lavdine tende.

Se te dáshkeshe therore, do te kisha prurë, po hollostet nuke te pelqejne.

Therore e Perendise eshte fryma e thyer; zemren e thyer dhe te perunjur nuke do ta hedhesh tej, o Perendí.

Bej-i mire Siones pas pelqimit tent; edhe nder-toji muret e Jerusalemit.

Ahere do te pelqesh therore drejtesie, dhurata dhe hollokoste.

Ahere do te bien dema mi alltarin tent, edhe meshirome, o Perendí.

*Pastáj thuhet Kanuni ne T. T. IV.:*

## IGRAN DHIODHEFSAS

I. U-hoth neper detin si ne steré, shpetój nga tirani, dhe armiku Egíptián, pópulli i mjere dhe therriste: Lavdí me ty Shpetimtár Perendí dhe Zot.

I mbytur prej ngásjeve si ne det, me ty po perikenj, dhe prej teje kerkónj shpetím, o Nene dhe Zonje Virgjereshe, prej çdo reziku dhe zie shpetome ti.

Pesimet me mbushne me trubullím, dhe shpirtin ma mbytnë, me merzitje dhe deshperím, po ti qetesome o Zonje, me ngushellimin dhe paqen e Birit tent.

Te lutem o Zonje o Shen Marí, qe linde Jesune, ti shpetome nga çdo rezík, me ty po perikenj dhe te lutem, me tere forcen e zemres dhe shpirtit tim.

Si shpirti dhe trupi keq m' u-semúr, pra ti me-

shirome, edhe syrin mi mua hith, kujdesu per mua Virgjereshe, e mire vete dhe Nen' e te mirit Bir.

III. Kryemjeshter i qellit, o Kryezót, qe nder-tove Kishen e Shenjte, ti me shiguró, se ti na dó dhe na ndih, ti i degjón mekatarët, ti besniket perhér' i mpron, ti njeridáshesi.

Si perkrahje dhe mprojtje, te jetes sime te kam, ty o Virgjeresh' e kulluar; ti pra me qeverís, dhe ne limanin me shpie, se ti na fal çdo te mire, ti besniket perhér' i mpron, Zonje Hyjlíndese.

Po te lutem o Zonje, e qetesó shpirtin tim, dhe pushoma shqoten e zemres. se po me bie zalí, se ti o Zonje Marí, ke lindur Mbretin e Paqes, Shpetimtarin Zotin Krisht, ti o Hyjlíndese.

Mirebéresin linde, qe beri çdo miresí, pasurísh te gjitha te mirat. epna te gjithëve, se ti ne dor' e ke, se ti ke lindur te fortin, Shpetimtarin Zotin Krisht, ti o Hyjlíndese.

Me semundje te liga, dhe çfardó pasión, dergjem un' i mjeri o Zonje, eja sherome ti, se s' te mungón asgjé, i ke te gjitha te mirat, je thesár per çdo sherím, ti o Hyjlíndese.

Shpetona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se te gjithë pas Perendise ty te pergjúnjemi, se ti je fortese qe nuke tundesh.

Shikome ti, me miresí o Hyjlíndese Virgjereshe, trupi m' u-semúr dhe m' u-çkaterrua si mos mé keq, dhe ti me sheró çdo plage te shpirtit.

*Pastáj Prifti kujtón atá, per te cilet behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, te lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe per shendetin, shpetimin edhe per ndjesen e mekátave te sherbetóreve te Perendise (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj kendohet:*

#### NDENJESORJA, T. II., TA ANO

Ti je nermjetím, fortese qe tronditje s' di, burón perdellím, o mprojtje e besníkeve, te therresim pra me mall: Virgjereshe Zonje Hyjlíndese, shpetona nga çdo helm e çdo rezík, se ti je e vétemja perkrahese.

*Pastáj vazhdón Kanuni:*

IV. Kam degjuar o Zoti Krisht, si e regullove keté mistér te math, kupetova veperimin tent, Shen Marí o Hyjlíndese, ti qe na ke lindur kapedanin e math, zbut-e shqoten e psímeve, qetesoji valat e mekátareve.

Né te gjithë te lútemi, dhempsherine tende tregona pa voním, ti qe linde njeridáshesin, Krishtin Shpetimtarin e besníkeve.

Per shumicen e dhurátave, te falenderójme né

mirenjóhesit, me kendime lavderónjese, Nene Virgjereshe dhe Hyjlíndese.

Ty të kemi përkráhesë, dhe fortësë të patundur dhe mprójtësë, Virgjereshe dhe Hyjlíndese, na shpëtón përherë prej rezíkeve.

V. Drite na dhuró, dhe tregona udhen ti o Zot, me porrositë dhe me krahun tent, dhe paqen tënde dhurona o mik i njéresve.

Zemren na e çel, me gezím edhe me ngazellím, dhe falna gazin e pasosur dhe pa funt, se ti ke lindur shkakëtarin e gezímeve.

Zonjë na shpëtó, Virgjereshe dhe Hyjlíndese, prej hélmeve edhe rezíkeve, se ti ke lindur Shpëtimtarin paqëprúresin.

Mjégullen largó, të mëkátave Hyjlíndese, me driten tënde jetëdhéncë, ti që ke lindur Díellin e parëjéteshme.

Zonjë na shëró, nga pesimet e semúndjeve, na meshiró edhe na vizitó, edhe shëndetin na dhuró me nermjetimin tent.

VI. Të fálurit Perëndisë do tja shtronj, dhe atí do tja tregónj hidherimet, se plot me vrer, shpirti im është mbushur, dhe jeta ime ka zbritur përpósh në Ferr, dhe lutem si Jonáj në det: Prej greminës me nxir Perëndí dhe Zot.

Atí iu-lut se prej vdekjes na shpëtó, si u-dha në thonjt' e vdekjes dhe vetë, prapë taní, shpirtin tim ta shpëtonjë, nga çkaterrimi i vdekjes dërmónjese, dhe nga armiku zemërlík, Biri yt e Zoti yn' o Hyjlíndese.

Si mprójtësë ty të di dhe rójtësë, të shigúrt' o Virgjereshe për jetën; ti i çpërndán, gjithë ngasjet e liga, dhe veprimet i dbon të demóneve; pra ty të lutem gjithënjé: Ti shpëto më prej gjithë pesímeve.

Fortés' e mur ty të kemi Hyjlíndese, dhe shpëtim për shpirtet tona të plote, dhe ngushellím, në mjerimet o Zonjë, dhe n' erresiren me drite na ngazellón. Pra ti o Zonjë dhe taní, nga pesimet e reziket ti na shpëtó.

Në shtrat taní i semurë shtrirë jam, dhe për trupin tim shërim nukë gjendet; vetëm pra ti, që ke lindur për botën, një Shpëtimtar dhe një Mjek të semúndjeve; pra ty të lutem dhe taní: Ti më ngër nga lengatat Hyjlíndese.

Shpëtona ti, prej çdo reziku Hyjlíndese Virgjereshe, se të gjithë pas Perëndisë ty të përgjúnjemi, se ti je fortësë që nukë tundesh.

Hyjlíndese, ti që në ditët e funtme taní ke lindur, Shpëtimtarin Zotin Jesú dhe Fjalën çuditërisht, për në iu-lut me kuximin e Nenes.

*Pastáj Prifti kujtón perserí atá për të cilet behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perëndí, pas meshires sate se madhe, të lútemi, dëgjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe për shëndetin, për shpëtimin edhe për ndjesën e mëkátave të shërbetóreve të Perëndisë (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit te Shenjte, taní dhe perhere dhe ne jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pas Thirrjes thuhet:*

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e te Krishtëreve, nermjetare e palodhur e besnikëve, ver-u veshin mekatáreve me dhempsherí. se po te therresim beserísht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Virgjreshë: Ndhna me nermjetimet, dhe lutjet meshireplote, dhe mpro perhere gjith' atá, qe te lusin o Hyjlíndese.

*Pastáj thuhet Shkallesa Kremtore me T. IV:*

Qe prej djalerise sime, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóhemi prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohet ne paqesí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerísht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jetelindje.

PARGVARK: Do ta kujtónj emrin tent ne gjithë brezat e brézave.

UNGJILLI PAS LUKAJT

M'ató dite, Mariama u-ngrit, edhe vajti me nxi-tím ne malesí, ne nje qytét te Judese, dhe hyri ne shtepine e Zaharise, dhe e pershendoshi Elisabeten. Dhe posá e degjój Elisabeta pershendoshjen e Marise, keceu foshnja ne barkun e saj. Dhe Elisabeta, e frymesuar prej Shpirtit te Shenjte, thirri me ze te math, edhe tha: "E bekuar je ti ne mes te grave, dhe e bekuar eshte pema e barkut tent. Edhe si me ngjau kjo lumerí, qe e-jema e tim Zoti te me vizitonje? Se ja, posa me tingelliu ne veshet pershendoshja jote, me keceu foshnja ne barkun me ngazellím. Dhe lum ajó, qe ka besuar, se do te permbushen fjalet, qe jane thene prej Zotit per até." Dhe Mariama tha: "Madheshtoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazellohu mi Perendine, Shpetimtarin tim; se e hodhi syrin mi shcrbetoren e perunjur; se ja qe-taní e tutje gjithë brezat do me lumerojne; se me madheshtój i Fuqishmi, dhe emri i tij esht i shenjte." Dhe mbeti Mariama bashke me até nja tre muaj, dhe pastáj u-kthye ne shtepine e vete.

LAVDI. T. II. Atë, Bir edhe Shpirt, nje Triní dhe Perendí, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

*Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shuaji paudhesít' e mia.*

## T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Mos me neverít taní, pa mprojte o Virgjereshe, Zonje dhe Hyjlíndese, eja prit-e lutjen e sherbetorit tent; helmi me permbyti krejt, nuke i durónj dot mé, shigjetimet e demónëve, strehe gjekundi s' gjenj, as ku te perikenj i várferi, lufte reth e rotull kam, tjtater ngushellím gjetke nuke shoh. Zonj' e tere botes, ti shpres' e mprojtje je per çdo besnik, mos m' i perbúz pra te lúturat, nem meshire dhe shpetím.

PRIFTI: Shpetoje popullin tent, o Zot, edhe bekoje trashëgimin tent; veshtroje boten tende me dhempsherí; lartesoje ballen e te Krishtëreve Orthodoxe, dhe dergona meshirat e tua te pásura. Me nermjetimet e Shen Marise, Kryezonjes sone, Virgjereshes edhe Nenes se Perendise; me fuqine e Kryqit te çemuar dhe jeteberes; me mprojtjen e Fórcave qellore e engjellore; te Shen Joán Pápczorit, Profetit edhe Parerëndesit; te Shen Apostujve te lavderuar dhe emershkelqyer; te Shen Basilit te Math, te Shen Grigór Theologut edhe te Shen Joán Gojartit, Aterve tanc te Shenjte, Kryeprífterve te medhénj dhe Mesónjesve ekumenike; te Shen Kollit, kryepeshkopit te Mýrave te Likise, çudibéresit; te Deshmóreve te Shenjte, te lavderuar dhe bukurmundes; te Aterve tanc oshenare dhe hyjprures; te Shen Joakimit edhe Shen Anes, Hyjprínderve te drejte; te Shenjtit te Kishes (*aksh*); edhe te gjithë

Shenjtóreve; o Zot meshireplót, degjona né mekataret, qe po te lútemi, dhe meshirona.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Me meshiren dhe perdellimin dhe njeridashjen e Birit te vetem, me te cilin je i bekuar, bashke me Shpirtin e Tereshenjte dhe te mire dhe jeteberes, taní dhe perhere dhe ne jetet e jeteve.

KORI: Amín.

*Pastáj vazhdón gjer ne funt Kanuni:*

VII. Te Tre Djemat e Judese, qe rastisne te ndodhen ne Babillone nje mot, nga besa e Trinitise, e shkelne flagen djégese te fures me lavderím: O Perendí Shpetimtár, o Zot je i bekuar.

Per shpetimin e botes, ne peqí virgjerór o Jesú Krisht, dhe Nenen Virgjereshe, e cila te ka lindur, na e bere si mprójtese. O Perendí Shpetimtár, o Zot je i bekuar.

Birit plot me meshire, qe ke lindur o Nen' e ku lluar lutu-i, te na i ndjenje fajet, dhe njollat shpirtore, se therresim me ze te math: o Perendí Shpetimtár, o Zot je i bekuar.

Thesarin e shpetimit, dhe burimin e paprishjes Nenen Hyjlíndese, keshtjellen e perikjes, dhe deren e pendimit, ua çfaqe besnikeve. O Perendí Shpetimtár, o Zot je i bekuar.

VIII. Zotin dhe Mbretin tone qellór qe bekoj-

me, ushterít' engjellore hymnoni, dhe e lartsoni me ze per gjithë jetet.

Mos i harró moj Zonje atá qe te luten, te hymnojnë me bes' e me shprese, dhe te lartsojnë me ze per gjithë jetet.

Ti i sherón perhere dhe pa u-kuryser, gjith' atá qe te luten moj Zonje, dhe te lartsojnë qe linde Zotin tone.

Ti na shpetón nga gjithë scmundjet e shpirtit, dhe nga dhembjet e trupit moj Nene, pra te lartsojnë Virgjereshe hirplote.

Ti i largón reziket dhe ngasjet e liga, dhe pesimet e repta moj Zonje, pra te lartsojnë me ze per gjithë jetet.

IX. O Nen' e Perendise, Zonje Virgjereshe, qe na shpetove me anen e Zotit Jesú, te madheshtojme me gjith' ushterít' e Engjejve.

Shikó si qanj me lote, edhe meshirome, se ti ke fshire çdo lot prej fytýrave, o Virgjereshe dhe Zonje qe linde Zotin Krisht.

Gezoje zemren time Zonje Virgjereshe, se ti ke lindur gezimin per njërezit, dhe çduke çdo helm me ndjesen e gjithë mekátave.

Limán dhe mprojtje behu, Zonje Virgjereshe, keshtjéll' e mur i patundur Hyjlíndese, perikje ndihme dhe mprojtje e gjithë njëresve.

Me rezet dhe me driten, ndritna Virgjereshe, edhe largó erresiren e méndjeve, t' atyre qe te leçitin Zonje Hyjlíndese.

Sherome Virgjereshe, se jam i permbysur, e-

dhe po dergjem ne shtratin e vójtjeve, po eja ngrerme dhe falme shendét edhe shpetím.

*Dhe me njehere thuhet:*

Ti je e nderuar mi Kerubím, dhe e lavdëruar pa perqasje mi Serafím; ti me te vertete linde Fjale Perendine; pra ty te madheshtojme, Zonje Hyjlíndese.

*Prihti temjanís Alltarin dhe pópullin, ose shtepine, ku behet lutja, dhe ne keté mes, kendohen Madheshtimet pasónjese:*

Ti je mé e larta mi qell e dhé, edhe ndrit me teper, se çdo díell a hen' e yll, ti qe na shpetove, te gjithë prej mallkimit, o Zonj' e tere botes, ty te kendojme sot.

Barra e mekátave me dërmón, m' u-semúr pra trupi, edhe shpirti m' u-err ne Ferr; me ty pra perikenj, Hyjlíndese hirplote, o shpres' e deshperimit, ti me shpetó taní.

Nen' e Shpetimtarit o Shen Marí, prit-i lutjet tona, te pavýera dhempsherisht, lutju pa pushuar, atí qe e ke lindur, o Zonj' e tere botes, ti nermjetó per né.

Kengen ta kendojme plot me gezím, ty moj e bekuar, Virgjereshe Zonje Marí. Tok me Shen Joanin, edhe gjithë Shenjtoret, o Zonje lutju Krishtit, te meshiróhemi.

Gojet e pabesa u-thafshin krejt, qe nuk adhurrojnë, koren tende besnikerisht, qe na u-tregua, prej nje historiani, Luká Shen Apostullit, si udhëçese.



Forca Engjellore mi qell e dhé, o Joán i Shenjte, Dymbedhjetë Shen Apostúj, të gjithë Shenjtoret, me Zonjen Virgjereshe, të gjithë nermjetoni, që të shpëtohemi.

*Pastáj thuhet Trishenjtí:*

KENDONJESI: Shenjt Perendí, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, meshirona (*3 here*).

Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe përherë dhe në jetet e jéteve, Amín.

Triní e Tereshenjte, meshirona; o Zot, hiresoji mekatat tona; o Kryezót, fal-i paudhesite tona; o i Shenjte veshtroji, dhe sheroji semundjet tona për emrin tent. Meshiró, o Zot (*3 here*).

Ati yne, që je në qell, u-shenjterofte emri yt; arthte Mbretëria jote; u-befte deshira jote si në qell edhe mi dhé; buken tone të përdítime épnaje neve sot; edhe fálnaji fajet, sikunder edhe né ua falim fajtoreve tanc; edhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është Mbretëria dhe fuqia dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj thuhet Troperet pasónjese me T. T. II:*

Kij meshire për né o Zot, kij meshire për né, se nukë kemi tjetër mprojtje, dhe perandáj né mekataret, perunjesisht po të lútemi: Kij meshire për né o Zot.

LAVDI. Kij meshire për né o Zot, se mi ty kemi patur besim; mos kij merí kunder neve, mos i kujtò padhesite tona, po shikona si meshireplót, dhe shpëtona prej armiqve tanc, se ti je Perendia yne, dhe né jemi pópulli yt, edhe veprat e dúarve të tua, dhe po thërresim emrin tent.

TANI. Çelna derën e meshires sate, o Hylíndese e bekuar, se me ty kemi shprese; mos na neverít po shpëtona prej rezíkeve, se ti je shpëtimi i të Krishtëve.

*Priifti kujtón perserí besniket, për të cilët behet lutja:*

PRIFTI: Meshirona, o Perendí, pas meshires sate se madhe, të lútemi, degjó dhe meshiró.

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Lútemi edhe për shendetin, për shpëtimin edhe për ndjesën e mekátave të shërbetoreve të Perendise (*aksh*).

KORI: Meshiró, o Zot (*3 here*).

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót edhe njeridashes, dhe ty të dergojme lavdí, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjte, taní dhe përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

*Pastáj Priifti thote Perleshimin e Shkurter:*

PRIFTI: Lavdí me ty, o Perendia yne, lavdí me ty.

KORI: Lavdí Atit edhe Birit edhe Shpirtit të

Shenjtc, taní dhe perherc dhe ne jetet e jéteve, Amín. Meshiró, o Zot (*3 here*). Bekó, o Ate.

PRIFTI: Krishti Perendia yne i vçrtete, me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve, na meshirofte, dhe na shpçtofte si i mire dhe njeridashcs.

KORI: Amín.

*Pastáj Vellézerit pershendoshin koren e Shen Marise, dhe ne keté mes kendohen Troparet pasónjese me Tingëllin e Dytë pas OTE EK TU KŠILU:*

Gjithe sa perikin i perkráh, nene mprojtjen tende te forte, o Zonj' e Shenjte Marí, tjater s'ke-mi nermjetím, perpara Zotit ne qell, ne rezík dhe ne hidherím, per né te kujdeset, né qe po permbý-semi, nga faj' i rende perdhé, Nen' e Perendise e lartc, ty po te pergjúnjemi ngrerna, dhe shpçtona né qe po te lútemi.

Gjithe sa helmohen i gezón, dhe i mpron sa jane te shtypur, sa kan' urí i ushqén, ti i pret te hú-ajtc, te vérberit i ndriçón, te semuret me kemb' i ngre, atá qe mundohen, ti i çloth e i forcón, edhe jetimet i rrit, Nen' e Perendise e lartc, ty po te pergjúnjemi ngrerna, dhe shpçtona né qe po te lútemi.

T. T. IV. Prit-i te fálurat, Shen Marí o Hyjlíndese, shpçtona gjithenjë, nga te gjitha shtrengicat e hélmeve.

T. II. Çdo shprese me ty e varr, o Zonje Hyjlíndese, Nen' e Zotit Krisht, ti me ruaj perhér' e ti me mpro.